



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 889/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Muhamet Rexha kryesues, Ymer Hoxha dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Kosova Turk Demokrati Partisi (KDTP) dega Mamush, paraqitur kundër komisionarëve të subjektit politik Kosova Turk Adaleti Partisi (KTAP) për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 18.11.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik KDTP dega në Mamush

**Arsyetim**

PZAP-i, me datën 15.11.2013 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik KDTP, ne të cilën kërkon që të bëhet rinumërimi i votave në Mamushë në vendvotimin nr.1 dhe nr.4 përshkak se komisionari i vendvotimit nr.4 ka sulmuar fizikisht kryesuesin e vendvotimit nr.1 pasi që nuk ka lejuar manipulimin e votave, andaj për rastin në fjalë parashtresë i ankesës thekson se kanë edhe raportin policor. Me këtë rast sipas parashtresës të ankesës pas këtij incidenti vendvotimi nr.1 është mbyllur për dy orë dhe se kryesuesi i këtij vendvotimi nuk e ka nënshkruar librin përfundimtar. Prandaj parashtresë i ankesës kërkon që të bëhet rinumërimi i votave në vendvotimin nr.4 dhe të anulohet vendvotimi nr.1

PZAP-i pasi që shqyrtoi shkresat e lëndës gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e pa bazuar dhe e pa argumentuar pasi që parashtresë i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë apo ndonjë dëshmi bindëse që do ti bënin të besueshme pretendimet e tilla ankimore të parashtuara në ankesë, andaj një pretendim i

tillë i ankesës është i pabazë dhe i pa argumentuar mirë në prova dhe në dëshmi bindëse, andaj duke u bazuar në nenin 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 889/2013 më datën 18.11.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.